



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

### **Nr. 16**

Datë: 23. 05. 2022. Ora: 11: 30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj dhe Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.13 dhe 14/2022**
- 3. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 4. Aktivitetet e ZRPPC-së**
  - Raport përmbledhës i aktiviteteve të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim
- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**
  - **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor, të zgjedhjeve të lokale 2021
- Shqyrtimi dhe miratimi i Agjendës së punëtorisë “Forcimi i komunikimit ndërmjet Zyrtarëve Komunal të Zgjedhjeve dhe Sekretariatit të KQZ-së”, e përkrahur dhe financuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë,
- **Këshilli për Personel**
  - Raport informues në lidhje me pozitat e shpallura sipas planit të rekrutimit për vitin 2021
  - Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të rekrutimit për vitin 2022
- **Këshilli për Çështje Ligjore**
  - Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Skenderaj

#### **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

- Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës së ish ACEEEEE-së, për pjesëmarrjen në Samitin Global për Demokraci 2022 - Forumi Rajonal Evropian

## **6. Të ndryshme**

---

### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

.....**Alim Rama**, shtroi pyetje nëse KQZ, e ka dërguar a se ka dërguar rekomandimin në Kuvend...? Ju, e keni cekur që drafti të përpilohet në këshilla, dhe mandej vendosen në KQZ. Pra, qysh është propozimi bazë. Në draft ligjin për propozimin në kuvend, ka qenë që paneli të përbëhet nga një anëtarë i brendshëm, dhe katër anëtarë të jashtëm. Ai ka qenë propozimi bazë i cili, ka ardhur mbas shqyrtimeve...Diku, trajtohet deri në pesë vjet... Unë, e kam parë draftin në 2019, por besoj që ka qenë edhe më herët. Atë draft që KCL e ka rekomandu, ose është dakordu që ai draft të jetë dhe paneli i që paneli i jashtëm, të zëvendësohet me një panel të brendshëm...Komenti im ka qenë i thjeshtë: më herët ka qenë, 1 me 4, më herët KCL ka kërkuar që të jenë të pestit....Ashtu siç, unë e kam cekë, duke marrë parasysh se në dy vjetët e fundit nuk ka pas një rekrutim të pozitave të larta që nuk ka përfunduar me kundërthënie dhe në procese gjyqësore...

S'ka pas proces meritokratik....! Ata, kanë pas parasysh këto që kanë rekomanduar panel të jashtëm, pra nëse shkon diçka në emër të KQZ, duhet paraprakisht të dakordohet në KQZ, ose nuk dërgohet fare...

Në diskutime, jo të gjithë jemi dakorduar me rekomandime të KCL-së dhe është normale, nuk ka diçka të jashtëzakonshme, por është dashur të diskutohet dhe ju kryetar, e keni mbyllë diskutimin dhe i keni dërguar në Kuvend, që domethënë nuk ka mbështetjeje të KQZ. Sepse, nuk është votuar në KQZ...

**Arianit Elshani:** Mirë që u ngritë me të drejtë se, a do të duhej apo nuk do të duhej të miratohej kjo në KQZ, por duke iu referuar procesverbalit dhe vendimmarrjes që kemi bërë ne si KQZ lidhur me këtë çështje, por edhe me kohën e limituar që na është ofruar lidhur me dhënien e atyre rekomandimeve për ndryshim plotësimin e ligjit për finanimin e partive politike sigurisht që, në rrethana të këtyra jemi dakorduar që rekomadnimi të shkojë...Tash, në raport me këto rekomandime e vlerësoj kontributin e secilit, por për disa prej tyre mundem edhe të mos jem dakord, por mendoj që duhet të bëjmë njëfarë kompromisi...

A do duhej të jetë ky format i përbërjes së atyre paneleve, apo së paku, kjo të jetë në ligjin për financimin e partive politike apo në ndonjë ligj tjetër, së paku në ligjin për zgjedhjet ku pastaj mund të përfshihen të gjitha organet e KQZ-së, përfshirë ZRPPC dhe Sekretariatit, në këtë rast shefin se SKQZ-së, këtu kemi mendime të ndryshme...

E pëlqej faktin që sot, KQZ mund të ketë tri qasje të ndryshme. E para, është një rekomandim për ndryshim plotësim që është kontradiktore me atë se çka kemi rekomandue ne, e dyta, janë subjektet politike me qasjen e tyre, dhe e treta, është qasja që është arritur si kompromis në Këshillin për Çështjet Ligjore. Për të gjitha këto, ne mund të mos jemi dakord....por, e vlerësoj faktin që komisioni i Kuvendit ka tre qasje të ndryshme, dhe duhet të trajtohen modelet e ofruara...Prandaj, nuk shoh diçka të keqe, sepse edhe ashtu ne jemi dakorduar...

**Ilir Gashi:** Së pari, nuk do të bëjmë politikë këtu, por ne duhet të jemi të sinqertë me veten dhe veprimet tona. Nuk është mirë që ne t'i delegojmë përgjegjësi një këshilli, dhe ne pastaj të mos pajtohemi me vendimet e atij këshilli. Nuk kam problem me z. Rama, por me cilësitë sepse, ky institucion tani më ka përvojë të madhe. Krejt çka është thënë në atë këshill për me i bërë disa formulime dhe me i drëzue në Kuvend, përqendrimi ka qenë me i mbrojtë të drejtat, kompetencat ligjore dhe kushtetuese të këtij institucioni... Propozimet e juaja, edhe ato të draftit fillestar janë propozime antikushtetuese dhe antiligjore gjë që kjo është cenim...

Askush tjetër nuk mund ti kryej detyrat e tona, me apo pa gabime. Por mendoj se ne i kryejmë detyrat dhe përgjegjësitë tona me kompetencë, dhe në bazë të ligjit... Vendimet që janë të deleguara në këshillë, ose duhet ti respektojmë ose, ti kthejmë këtu...

**Sami Hamiti:** Thënë drejtë, me këtë draft ligj dhe me këtë dokument unë jam i familjarizuar nga 2018, e deri sot, me të gjitha vërejtjet që i ka pas por as një pikë dhe asnjë presje nuk është ndryshua. Se plotëson asnjë kriter të jetë ligj, ose edhe të trajtohet në Kuvend. Por, ky është mendimi im ! Ne jemi marrë vesh këtu që ta trajtojmë atë draft, aq sa mundemi... A e prekë kushtetutën, po, a ka kundërshti mes institucionet të pavarur, ligjit për zgjedhjet, dhe drafit që është, po ka...!

Ky ligj bjen, sepse është antikushtetues ! Edhe si akt, nuk i përmbush kriteret sepse, i ka "100" kundërshti brendapërbrenda... E tash, e humb ky draft edhe të drejtën e KQZ-së të qenurit organ kolegjal, sepse ja jep të drejtën kryetarit me aprovue dhe me shkarkue....Analizojeni mirë, sepse është në kundërshti të plotë me organin tonë si organ kolegjal...Në anën tjetër, ne jemi përpjekur ta ruajmë substancën e organit kolegjal...

Si këshill i kemi analizue dhe jemi dakordua që, diçka tjetër mundet me qenë por, atje thuhet se "krkyesuesi e emron", ne kemi me trajtue por s'guxojmë me preka kurgja ! Pra, pse të silllet diçka nëse ne të pandryshuar, kemi me dërgue ose me aprovue ? Kjo, krijon zyrtar mbi zyrtar brenda institucionit...Ne, e kemi trajtue, kemi marrë miratimin në KQZ, dhe si këshill e kemi dërgue...

**Sami Kurteshi:** Kam qenë pjesë e këshillit, atë ditë jemi pajtue...E kam lexues sugjerimin e z. Rama, dhe po unë pajtohem me një pjesë...E dyta, këshilli ligjorë e ka trajtue, kemi bërë disa ndryshime...E treta, këshilli i ka dërgue imellat te anëtarët e KQZ, dhe kjo nënkupton se KQZ duhet ta miratojë...

Por, ne duhet ta kemi parasysh: kemi marrë vendim që raporti të bëhet, të ndryshohet mbi analizat e bëra, por masandej raporti është ndryshuar...Pra, raporti po mujka me u ndëryshue me imell e nëpër zyre...? E këtu, diçka që është e obligueshme s'po mujka me u ndryshue...?

Ne, kemi qenë të interesuar ti dërgojmë rekomandimet tona...Por, ne duhet me i marrë vërejtjet dje me i analizue, dhe jo me i kthye në "cilësime", me i marrë faktet....Cilat janë faktet, dëshmitë ? Dhe unë mendoj që kërkesa e z. Rama është e drejtë... Ne, po, kemi dhënë kontributin tonë, ka pas gjëra që jemi pajtuar dhe të tjerat që s'jemi pajtuar...Prandaj, vërejtjen e kolegut Rama e marrë seriozisht, dhe duhet me e trajtue... A pajtohem apo nuk pajtohem, është tjetër gjë...! A kanë me i marrë mendimet tona si relevante në Kuvend ? Mendoj që jo, sepse as nuk jemi pjesë e diskutimit lidhur me ligjin...Hiq nuk na kan pyetur, ne kemi bërë atë që kemi mundur...

Jam pajtuar më shumë me propozimin e z. Rama se e ka bërë për një arsye, se e ka ba një kompromis mes atij propozimit që e ka ba, se di kush e ka ba, komisioni parlamentar apo subjektet politike që paneli me qenë krejt i jashtëm, dhe ne e kemi bërë një propozim që paneli me kanë krejt i brendshëm...Propozimi i z. Rama ka qenë një kompromis...? A merren parasysh, nuk e di....Por, po e theksoj se ne kemi marrë vendim në KQZ me e hartue raportin me të gjitha vërejtjet, propozimet dhe rekomandimet që i kemi bërë...

Ai raport, ka shuke pa ato përmirësime...Ne, jemi marrë vesh me e diskutue ligjin për subjektet politike në këshill, dhe ne ua kemi dërgue të gjithë anëtarëve për me e analizue, dhe një prej anëtarëve nuk është pajtue... Unë mendoj që kështu, ne nuk duhet t'i marrim çështjet sepse KQZ e ka për detyrë me diskutue për çështjet: "me u pajtue – dhe mos me u pajtue..."

**Kreshnik Radoniqi:** Ky debat po më shtin me mendue se, jo krejt korrekt jemi me njeri tjetrin. E dyta, unë nuk kam me lejue asnjë vendim me u marrë pa qenë përfundimtari, dhe pastaj me u votue sikur në këtë rast që, pa ardhë në komision mos me u miratue asgjë...

Nuk është e vërtetë z. Kurteshi që ne kemi vendosur me e pru prapë në komision, por unë e kisha lutur z. Fehmiun që këtë pjesë të procesverbalit të mbledhjes "15" që këtë pjesë me e bërë përshkrimin fjalë për fjalë, vetëm të kësaj pjese... Se, mos të kish qenë kështu si jemi marrë vesh, unë nuk e kisha lejua në atë mënyrë me shkue përmes drejtorit, por ne jemi marrë vesh që këshilli për çështje ligjore me e trajtue, dhe e kanë trajtue 3-4 orë, dhe ata pastaj me e dërgue në komisionin parlamentar...Nuk kemi thënë që prapë me que në KQZ, dhe me e trajtue sepse, e kemi pasur kohën e shkurtë dhe, dy anëtarë prej neve, nuk kanë pas me qenë këtu...

Kjo, mua po më doket jo korrekte, dhe tash me thënë "jo nuk është ashtu"...Nuk e kamë atë çështjen e rekomandimeve, si të doni bënja, unë jam këtu me e zbatue një ligj dhe po due me qenë korrekt me juve, por edhe dua me qenë korrekt me mue: ne, jemi marrë veq raportin me e dëruë në këëshill, pikë dhe me e dërgue në komisionin parlamentar, pikë; Në atë mbledhje ju thash që nuk pe votojmë tani, ju thatë jo pe votojmë tani dhe, u përzie puna...

Tash e tutje, nuk kemi me dërgue asgjë tutje pa u votuar, kurgja ma s'ka me shkue pa u votuar...Edhe nëse ka me pas një ndryshim sa do të vogël, ka me shkue, me u ba ndryshimi, mu kthye dokumenti dhe me u votue...

**Čemailj Kurtiši:** Ju falemndeit kryetar, unë vlerësoj që nuk ka më nevojë që rreth kësaj të diskutojmë. Mirë kjo u zbërthey, dhe për një pjesë e kisha mendimin tim që, tash edhe po e them: Qëndron konstatimi,

dhe është e qartë edhe për juristët ajo që mund ta quajmë s'i "konstatimi mbi punën" ( ai, mori dhe një shembull rreth kësaj), prandaj edhe ne, njëjtë, për shkak të kohës, finishit të kohës është dashur që raporti t'i dërgohet kuvendit... dhe ne, ia kemi dhënë këshillit dhe është trajtuar rreth katër orë; Si KQZ në parim ne e kemi miratuar raportin që mandej, dhe s'ka pasur as kohë që pastaj tu dërgohet përsëri anëtarëve të KQZ-së; Ajo që është përfundua, është përfundua dhe është dërguar tutje...Mendoj që, në parim ne jemi dakordue...! Në të ardhmen, duhet të kemi kujdes që puna të fillohet më herët, më herët të na dërgohet materiali që ne të kemi kohë që versionet ti hartojmë, ti analizojmë, ti japim vërejtjet....Nuk kemi pasur kohë, dhe mendoj që kjo ka kaluar dhe s'kemi arsye më tutje që të merremi me këtë...

Mendoj që kemi punuar, jemi marrë me raportin...

**Alim Rama:** Nuk do të merrem me atë që u tha, me cilësime por unë jam që të respektohen procedurat, se në imell unë i përmenda çështjet faktike se, si KQZ ne kemi dështuar në disa raste në rekrutime; Rekrutimet janë këtu problematike, besoj edhe draftuesit e kanë parë që këtu ka probleme...Sido që të jetë, ka qenë një rekomandim por, në momentin që ka një mos pajtueshmëri mendoj që duhet të diskutohet, dhe s'mundemi të themi se ka edhe 5 minuta kohë dhe hajt të shkojmë tutje...! Duhet mu kthye, me vlerësua dhe nëse nuk kuptohemi, edhe nëse shumica janë kundër jemi në rregull...por, unë kam pasur problem me procedurat, sepse në fund edhe njëherë: unë e kam pasur problemin me procedurat sepse, në fund është propozuar që të formohet një grup dhe materiali të shqyrtohet në këshill...S'mundemi me vazhdua kështu, një element me interpretua në një mënyrë, dhe një tjetër në një mënyrë tjetër...Kolegu e përmendi, z. Kurteshi e përmendi raportin vjetor, por ne po e shohim që nuk respektohen procedurat, edhe vendimet... Këtu është problemi, dhe pajtohem me atë që thatë që, këtu të merren vendimet...

**Ilir Gashi:** Mirë që u pajtuat me mendimin e kryetarit, dhe pajtohem edhe me ju...por, unë mund të mos jem, as ju, vijnë të tjerët, ndërrohem por, e rëndësishme është që ne ta mbrojmë këtë institucion...

Epo, shiko çka ke thënë në imell..."KQZ nuk është në gjendje me zhvillua procedura" ! Nëse ju z. Rama nuk jeni në gjendje, ne jemi 11 këtu në gjendje me zhvillua procedura. Dhe, nëse ju z. Rama nuk guxon të jepni cilësime s'i "KQZ"-ja, dhe për këtë arsye po them sepse vec asaj që thonë në "dy vitet e fundit ku keni qenë ju", ti thu "edhe më herët" ...! Me çfarë konstatimi thue "edhe më herët" ...?

Për këtë arsye, unë nuk jam pajtua me cilësimin dhe jo me propozimin...! Unë, propozimin unë e kam dhënë në këshill...prandaj, mendoj që në mbledhjen e ardhshme duhet me ardhë edhe procesverbali ku është trajtua, dhe kjo qoftë në një mbledhje të veçantë...

**Sami Kurteshi**: Unë, pajtohem që jemi institucion që duhet të punojmë në parime ligjore, a ka besim a s'ka besim, e shohim...! Z. Gashi, tha se ne 11 jemi pajtuar....por, edhe unë i kam dhënë vërejtjet e mia rreth rekrutimeve, por unë andej nuk po dua me hy; Ne, duhet me punua sipas procedurave që i kemi këtu, dhe pajtohem plotësisht...Ajo çka vendoset këtu, edhe gabim në qoftë, kur vendoset në KQZ, është vendim i KQZ, me, apo pa gabime...Dhe me këtë pajtohem plotësisht...

Ne, modemi me punua në këtë mënyrë hiq pa pasur besim, apo me pasur besim, pra i kemi procedurat, i kemi normat...

**Kreshnik Radoniqi**: Kalojmë në pikën e radhës, dhe tash e tutje, nuk ka me u votue asgjë pa qenë përfundimtare...

## **2. Aktivitetet e ZRPPC-së**

### **Raport përmbledhës i aktiviteteve të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim:**

**Nexhmedin Hyseni**, drejtor i ZRPP-se, tha se nder aktivitetet e zyrës mes dy mbledhjeve, më datën 16 prill, 2022, zyrtarja Vesa Xharra ka përcjellë kuvendin e parë themelues të subjektit politik “Forca e Diasporës” të mbajtur në Prishtinë, dhe se dokumenti i nevojshëm i subjektit është sjellë në zyrë. Është konstatuar nga zyra se, kuvendi ka qenë në rregull...

Një kërkesë nga një subjekt politik, e kemi pranuar dhe ju e keni në raport. Zyra, ka kryer edhe njëherë një procedurë të njëjtë, themi ashtu, një detyrim që ka rrjedhë prej KQZ mirëpo, është çështje administrative... Ka të bëjë me Partinë Demokratike të Unitetit. Më 16 maj, zyra ka pranuar një kërkesë që ka të bëjë me një vizitë studimore nga një profesor i studimeve master nga fakulteti juridik, i UP-së dhe më 19 maj, ne kemi pritur një ekip të këtij fakultetit...Kjo, është vizita e parë e këtillë në institucionin tonë...

Kushtimesh, vizita ka pasur të bëjë rreth interesimit për procesin zgjedhor...Takimi ka zgjatur një orë e gjysmë..

Zyra, gjithashtu ka pranuar edhe një kërkesë nga OSBE/ ODIRI me seli në Varshavë për një takim konsultativ, i cili takim do të zhvillohet me 1 qershor, 2022. Kemi pranuar edhe një kërkesë nga IFES, me një temë rreth hulumtimit mbi zgjedhjet, e ku IFES këtë hulumtim është duke e zhvilluar në 10 vende...

Por, ne kemi edhe një kërkesë nga një subjekt politik për monitorim të kuvendit më 25 maj, dhe zyra do ta përcjellë këtë kuvend...

**Sami Kurteshi**, kërkoi që raportet e zyrës të jenë më koncize, sepse për shembull nuk kemi një “konstatim të shkruar” se si ka vajtur kuvendi i partisë në fjalë...

**Nexhmedin Hyseni**, tha se raporti u është dërguar i plotësuar, dhe se konstatimi im në mbledhje, është bërë mbi gjendjen reale... Kurse, subjekti që na ka lajmërua për kuvend, është “Ekopartia”, “Të gjelbërit e Kosovës”...

### **3.Raport i Këshillave të KQZ-së:**

#### **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

1.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor, të zgjedhjeve të lokale 2021:

**Arianit Elshani**, tha se e ka shqyrtuar procesin e asgjësimit ( shkatërrimit) të materialit zgjedhor për zgjedhjet lokale 2021, mbas një vendimi që ne e kemi marrë lidhur me ruajtjen e kutive të votimit që janë objekt i hetimit nga prokuroria, dhe nga PZAP. Bëhet fjalë për 281 kuti që ruhen brenda QNR –së. Sekretariati, obligohet ligjërisht që të bëjë asgjësimin e 1214 kutive të votimit bashkë me materialet në vendvotimeve.

Z. Elshani, e informoi KQZ-në se, cilat materiale shkatërrohen...dhe se, sekretariati do të marrë masa...Mediat, por edhe subjektet politike do të informohen për këtë proces, nëse duan të jenë prezent në proces...

**Sami Kurteshi**, pyeti se këto materiale asgjësohen vetëm për zgjedhjet lokale...? Por, çka ka ndodhë me kutitë e mëhershme për zgjedhjet nacionale, a janë shkatërruar apo...?

**Burim Ahmetaj**, shpjegoi se ka materiale me vite të ruajtura si rezultat i hetimeve të prokurorisë dhe kërkesave të PZAP-së...Konfirmoj se këto materiale janë nga viti 2012 e këndej, kurse materialet e mëhershme tashmë, për shkak të parashkrimit të tyre, janë asgjësuar... Asgjësohen vetëm materialet e zgjedhjeve lokale, në mënyrë që të plotësohet obligimi ynë ligjorë...



Në fund, me vota unanime, miratohet rekomandimi për asgjësim të materialit zgjedhor të zgjedhjeve lokale 2021.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Agjendës së punëtorisë “Forcimi i komunikimit ndërmjet Zyrtarëve Komunal të Zgjedhjeve dhe Sekretariatit të KQZ-së”, e përkrahur dhe financuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë:

**Arianit Elshani**: Në kuadër të planit të punës së këtij viti, dhe për të përcjellë punën e KKZ-ve, ne e kemi shqyrtuar organizimin e një punëtorie, dhe ne rekomandojmë që kjo të miratohet...

**Në këtë pikë, shtruan pyetje dhe diskutime rreth përmbajtjes së punëtorisë:** Sami Kurteshi dhe Alim Rama.

Në fund, me 9 vota për, u miratua rekomandimi për organizimin e punëtorisë: “Forcimi i komunikimit ndërmjet Zyrtarëve Komunal të Zgjedhjeve dhe Sekretariatit të KQZ-së”.

### **Këshilli për Personel**

#### **1. Raport informues në lidhje me pozitat e shpallura sipas planit të rekrutimit për vitin 2021:**

**Alim Rama**: Në mbledhjen e mbajtur sot, e kemi diskutuar zbatimin e planit të rekrutimit të vitit 2021. Për këtë vit, kanë qenë 3 pozita: Zyrtar i lartë i Listës Votuese, zyrtar i KKZ-së në Mamushë, dhe zyrtar i KKZ-së në Lipjan. Deri sa për dy pozitat e fundit, Sekretariati nuk i ka përfunduar, te rasti i “Zyrtarit i Lartë i Listës Votuese”, ka problem sepse, ky konkurs është shpallur në qershor, pastaj është anuluar, pastaj është rishpallë më 11 tetor... Procesi, ka përfunduar mirëpo, për shkak të kërkesë së një anëtari të komisionit, Sekretariati e ka anuluar... mirëpo, personi që ka fituar është ankuar në KPMSHKC dhe, ky komision ka konstatuar se vendimi i panelit rekrutues ka qenë i drejtë...

Sekretariati i zyrës, është ankuar në këtë vendim të KPMSHC-së dhe procesi, tani ka përfunduar në gjykatë... Gjykata, ka marrë vendim ( masë pezulluese), deri sa të bëhet trajtimi adekuat i gjykatës...

S'i anëtarë i KQZ, tani po diskutoj jo si kryesues i këshillit: për mua, është shqetësues fakti se Sekretariati ose Kryeshefi, pa vendim të KQZ-së, e ka ankumuar rastin...! Kjo, s'ka qenë praktikë...Tash, mendoj se ka pasur tejkalim të kompetencave të kreyshefit...

**Ilir Gashi**, tha se kjo është e drejtë e Sekretariatit. Ne, si KQZ kemi të drejtë të merrmi me ata që ne i zgjedhim, kurse stafi civil, me këtë rast, kjo çështje nuk është punë e këtij organi...Ne, s'kemi të drejt të përzihemi sepse, janë konkurse që i nënshtrohen ligjit mbi shërbimin civil...Unë, as nuk përzihem, ne nuk e kemi këtë të drejtë...

**Sami Hamiti**, tha se çështjet që rekrutohen nga ekzekutivi janë të ekzekutivit, kurse KPMSHC-së nuk i marrin lëndët e institucioneve të pavarura...ky këshill, nuk e ka ma këtë kompetencë me një institucion të pavarur dhe nuk i nënshtrohet ligjit civil... Ne, s'mund të marrim ndonjë vendim...për, apo kundër...

**Ibrahim Selmanaj**: Në mbledhje të këshillat, kishim debat por edhe kishim mos marrëveshje...Por, sekretariati të na e përgatit një raport, por edhe të shohim se, disa vende duhet të plotësohen patjetër, dhe sidomos, të mos kemi ushtrues detyre... Thjeshtë, duhet të kemi një raport detaj lidhur me rekrutimet...

Në këtë pikë, diskutuan: Arianit Elshani, Sami Kurteshi, Alim Rama, dhe Kreshnik Radoniqi diskutimet e të cilëve, u fokusua lidhur me kompetencat e Sekretariatit dhe Krye shefit, qoftë në raport me KQZ-në dhe qoftë në relacion me institucionet e jashtme (relevante).

## **2. Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Skenderaj:

**Sami Hamiti**, tha se këshilli, ka shqyrtuar një zëvendësim në komunën e Skenderajt, dhe se, zyra ligjore konstaton se janë përmbushur kriteret, dhe këshilli e rekomandon këtë zëvendësim”

**Kreshnik Radoniqi**: Në komunën e Skenderajt, asambleistja Brikena Zeqiri, zëvendësohet Ferdane Beqiri – Emini, nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Me vota unanime, miratohet ky rekomandim

## **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës së ish ACEEEEEO-së, për pjesëmarrjen në Samitin Global për Demokraci 2022 - Forumi Rajonal Evropian:

**Kreshnik Radoniqi**, tha se, e kemi një imell nga ish ACEEO për pjesëmarrje në samitin global për demokraci zo22 – forumi rajonal evropian për demokraci. Edhe në këshill, kam thënë se para se mu shpërbë ACEEO, vetë sekretariati do ta fillojë ri konfigurimin, pra një iniciativë të re...

Ne, na është dërguar ftesa, dhe në këshill në parim, u akordua që unë të marrë pjesë...Po ashtu, dikush të marrë pjesë edhe nga Sekretariati..

Nëse, ju mendoni që të jetë dikush edhe nga KQZ...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Ilir Gashi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Arianit Elshani, Sami Kurteshi, Rifat Krasniqi dhe Burim Ahmetaj.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është që të shkojnë dy veta, një nga KQZ dhe një nga SKQZ...?

Miratohet...

**Për KQZ**

**Kryetari: Kreshnik Radoniqi**

-----